

# UNMIK



Authority Office

Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina  
regulatorni Ured za Vodu i Otpad



ZRRUM – R 01 / W&WW

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA (ZRRUM)

---

**RREGULL**

**PËR LICENCIMIN E**

**OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA  
DHE TË FURNIZIMIT TË UJIT ME SHUMICË NË KOSOVË**

26 Janar 2005

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b> .....	4
Neni 2: Përfshirja .....	4
Neni 3: Qëllimi.....	4
Neni 4: Përkufizimet .....	4
Neni 5: Rregullat e Interpretimit .....	7
<b>PJESA II: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË LICENSËS SË SHËRBIMEVE</b> .....	7
Neni 6: Aplikueshmëria .....	7
Neni 7: Afati i Licensës së Shërbimit .....	7
Neni 8: Numri i Licensave për Shërbime.....	7
Neni 9: Shpenzimet për Marrjen e Licencës së Shërbimit.....	7
<b>PJESA III: APLIKIMI PËR LICENSË TË SHËRBIMIT</b> .....	8
Neni 10: Afatet për Aplikimin për Licencë të Shërbimit.....	8
Neni 11: Parashtrimi i Kërkesës për Licencë të Shërbimit .....	8
Neni 12: Aprovimi i Bordit Mbikqyrës.....	8
Neni 13: Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit .....	8
Neni 14: Aprovimi i Deklaratave Financiare nga Agjensia Kosovare e Mirëbesimit .....	8
Neni 15: Dëftesa nga Rregullatori.....	9
Neni 16: Informatat e Përgjithshme për Identifikim .....	9
Neni 17: Zona e Shërbimeve, Banorët e Shërbyer .....	9
Neni 18: Burimi i Ujit, Përpunimi dhe Deponimi në Rezervoare.....	10
Neni 19: Sistemi i Shpërndarjes së Ujit .....	10
Neni 20: Grumbullimi dhe Derdhja e Ujërave të Zeza .....	10
Neni 21: Personeli .....	10
Neni 22: Tarifat e Shërbimit .....	11
Neni 23: Përvoja Paraprake e Punës .....	11
Neni 24: Biografia e Personelit Menaxhues.....	11
Neni 25: Autorizimi nga Komuna ku ofrohen Shërbimet.....	11
Neni 26: Autorizimi për të Nxjerrë Ujë ose për të Zbratur Ujërat e Zeza.....	11
Neni 27: Dokumentet Afariste .....	12
Neni 28: Dokumentet për Obligime ndaj Ndërmarrjeve Shërbyese dhe Obligime Tatimore .....	12
Neni 29: Dokumentet Tjera.....	13
<b>PJESA IV: SHQYRTIMI DHE LËSHIMI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT</b> .....	13
Neni 30: Shqyrtimi i Përgjithshëm i Aplikacionit për Licencë dhe Dokumentet e Bashkangjitura.....	13
Neni 31: Pamundësia për të Ofruar Informatën e Kërkuar .....	14
Neni 32: Shqyrtimi i Detajizuar i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit dhe Dokumentet e .....	14
Bashkangjitura.....	14
Neni 33: Kërkesa për informata plotësuese .....	14
Neni 34: Lëshimi i Licencës së Shërbimit .....	14
<b>PJESA V: LICENCA E SHËRBIMIT</b> .....	15
Neni 35: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit .....	15
Neni 36: Obligimet për Aplikuesit për Licencë të Shërbimit .....	15
Neni 37: Detajet që janë Specifike për Aplikuesit e Caktuar për Licencë të	

Shërbimit.....	16
Neni 38: Taksa për Licencë te Shërbimit.....	16
<b>PJESA VI: REFUZIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT .....</b>	<b>17</b>
Neni 39: Refuzimi i Kërkesës së Licencës së Shërbimit.....	17
<b>PJESA VII: PËRTËRIRJA DHE TRANSFERI I LICENCËS SË SHËRBIMIT ..</b>	<b>17</b>
Neni 40: Ripërtërirja e Licencës së Shërbimit .....	17
Neni 41: Aplikacioni për Ripërtërirjen e Licencës së Shërbimit .....	17
Neni 42: Transferi i Licencës së Shërbimit.....	18
<b>PJESA VIII: NDRYSHIMET, NDËRPRERJA DHE REVOKIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT .....</b>	<b>18</b>
Neni 43: E drejta e Rregullatorit të Ndryshojë, Plotësojë ose të Zëvendësojë 18	
Neni 44: Shqyrtimi i Kualifikimeve të Drejtorit Menaxhues.....	18
Neni 45: Informimi i Rregullatorit për Ndryshime Sinjifikative .....	19
Neni 46: Ndërprerja e Licencës së Shërbimit .....	19
Neni 47: Revokimi i Licencës së Shërbimit.....	19
Neni 48: Heqja dorë nga Licenca e Shërbimit .....	19
<b>PJESA IX: MARRËVESHJA PËR LICENCË TE SHËRBIMIT .....</b>	<b>20</b>
Neni 49: Marrëveshja për Licencë te Shërbimit .....	20
Neni 50: Negociatat e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit.....	20
Neni 51: Lidhja e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit.....	21
Neni 52: Karakteri Ligjor dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit .....	22
Neni 53: Përmbushja e Kushteve të Licencës së Shërbimit.....	22
<b>PJESA X: VËNIA NË FUQI, GJOBAT DHE ANKESAT .....</b>	<b>22</b>
Neni 54: Vënia në Fuqi e Kushteve të Licencës së Shërbimit .....	22
Neni 55: Raportet për Kushtet e Licencës së Shërbimit .....	23
Neni 56: Kundërvajtjet dhe Dënimet .....	24
Neni 57: Ankesat.....	24
<b>PJESA XI: TË NDRYSHME .....</b>	<b>25</b>
Neni 58: Gjuhët Zyrtare të Rregullës .....	25
Neni 59: Hyrja në Fuqi.....	25
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>26</b>
<b>SHTOJCA 1.....</b>	<b>27</b>
FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE PËR SHËRBIMET E FURNIZIMIT TË UJIT ME SHUMICË NË KOSOVË .....	27
<b>SHTOJCA 2.....</b>	<b>30</b>
AUTORIZIMI I BORDIT MBIKQYRËS.....	30
<b>SHTOJCA 3.....</b>	<b>31</b>
APROVIMI I DEKLARATËS FINANCIARE .....	31
<b>SHTOJCA 4.....</b>	<b>32</b>
FORMAT I CURRICULUM VITAE BASHKANGJITUR ME APLIKACION PËR LICENCË .....	32
<b>SHTOJCA 5.....</b>	<b>33</b>
LISTA KONTROLLUESE E KOMPLETIMIT ADMINISTRATIV PËR APLIKACION PER LICENCE TE SHERBIMIT .....	33
<b>SHTOJCA 6.....</b>	<b>36</b>
CERTIFIKATA E LICENCIMIT E ZRUM PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË.....	36
<b>SHTOJCA 7.....</b>	<b>37</b>
PËRMBAJTJA E LICENCËS SË SHËRBIMIT TË ZRUM.....	37

## **PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1: Autoriteti i këtij Rregulli**

Rregullatori lëshon këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë.

### **Neni 2: Përfshirja**

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që ofrojnë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Furnizuesit e Ujit me Shumicë në Kosovë do të aplikojnë për Licencë të Shërbimit nga Rregullatori.

### **Neni 3: Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulle është të themelohet sistemi sipas së cilit do të aplikohet për dhënien, mirëmbajtjen, përtërirjen, ndryshimin dhe revokimin e Licensave të Shërbimit për ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Furnizuesve të Ujit me Shumicë.

### **Neni 4: Përkufizimet**

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

**Aplikuesi** ka kuptimin e njëjtë si Aplikuesi për Licencë;

**Aplikuesi për Licensë të Shërbimit** nënkupton cilëndo Ndërmarrje Publike e cila dorëzon të Rregullatori Aplikacionin për Licensën e Shërbimit;

**Aplikacioni për Licensë të Shërbimit** nënkupton informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga Aplikuesi për Licensë me qëllim që të merr Licensën nga Rregullatori;

**Aplikimi për Licencë** nënkupton dorëzimin e kërkesës nga ana e aplikuesit tek Rregullatorit në formatin e specifikuar nga Rregullatori;

**Autoriteti Menaxhues** nënkupton autoritetin dhe pushtetin e dhënë me marrëveshje me shkrim të bërë në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza dhe cilitdo Ofrues Tjetër të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza ku në mënyrë specifike theksohet që (1) Ofruesi i caktuar i Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza është i autorizuar dhe përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe operimet e ndonjë Ofruesi tjetër të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza në Zonën e Shërbimeve dhe (2) që Ofruesi tjetër i Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza në Zonën e Shërbimeve do të përmbush kërkesat e marrveshjes në fjalë;

**Furnizuesi i Ujit me Shumicë** nënkupton cilindo Person i cili furnizon Ujë me Shumicë për Ofruesit e Shërbimeve për Ujë;

**Ditë Pune** nënkupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;

**Faturë** nënkupton njoftimin me shkrim për të paguar për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza, e cila saktëson shumën e borxhit që është e pagueshme, dhe periudhën për të cilën janë ofruar shërbimet, të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza tek Konsumatori në gjuhën Shqipe dhe Serbe;

**Konsumator** nënkupton çdo person që ka lidhë Kontratën e Shërbimit për Ujë dhe Ujëra të Zeza apo kontratën për Furnizim me Ujë me Shumicë që në mënyrë të ligjshme ka marrë Shërbime për Ujë të furnizuara nga Ofruesi i Shërbimeve;

i. **Konsumator Shtëpiak** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;

ii. **Konsumator Komercial/Industrial** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumatori i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;

iii. **Konsumator Institucional** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste në Kosovë.

**Komuna** nënkupton çdo njësi territoriale themelore e vetëqeverisjes në Kosovë që punon sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/45 të datës 11 gusht 2000 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë;

**Kushtet e Licencës së Shërbimit** nënkupton kushtet specifike nën të cilat Rregullatori lëshon Licencë të Shërbimit tek Ofruesit e Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza dhe/apo Furnizuesit të Ujit me Shumicë;

**Licenca e Shërbimit** nënkupton licensën e lëshuar nga Rregullatori konform kësaj Rregulle e cila autorizon Ndërmarrjen Publike të ofrojë Shërbime për Ujë dhe Ujëra të Zeza tek publiku;

**Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit** nënkupton marrëveshjen e cila mund të lidhet në mes të Rregullatorit dhe Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza dhe/apo Furnizuesit të Ujit me Shumicë që të ndryshojë, modifikojë, shndërrojë dhe plotësojë cilatdo Kushte të Licencës së Shërbimit sipas dispozitave të PJESA IX eë kësaj Rregulle;

**Marrëveshja për Shërbime** nënkupton marrëveshjen e nxjerrur nga Komuna dhe Ofruesit e Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza nën kontrollin dhe mbikqyrjen e Rregullatorit për ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza brenda zonës së seciles Komunë të veçantë dhe në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe obligimet e të dy palëve në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

**Ndërmarrje Publike** nënkupton atë Ndërmarrje e cila është themeluar si ndërmarrje në pronësi shoqërore nga Krahina e Kosovës, një komunë, ose organizata tjera politiko-publike përbrenda Kosovës siç është e definuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të 13 qershorit 2002 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”;

**Ndërmarrje Shoqërore** ka kuptimin e njëjtë sikurse në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të 13 qershorit 2002 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, domethënë: Ndërmarrja e cila është krijuar si pronë shoqërore me Ligjin për Ndërmarrje, Ligjin për Punën e Bashkuar të Republikës Federale të Jugosllavisë ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm në Kosovë,

**Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza** nënkupton Personin që ofron apo që mendon të ofrojë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

**Person** nënkupton një individ, subjekt legal apo publik duke përfshirë korporatë, ortakëri, trust, organizatë jokorporuese, agjenci apo sektor qeveritar;

**Plani i Konsolidimit** nënkupton planin për ristrukturimin e sektorit të krijuar nga Agjensia Kosovare e Mirëbesimit (“AKM”) për konsolidimin dhe ristrukturimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, dhe Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave të Ngurta të datës 10 shtator 2002 dhe ndryshimet, plotësimet apo zëvendësimet që i bëhen kohë pas kohe nga AKM-ja;

**Praktikat e Mira të Ndërmarrjeve për Shërbime Publike për Ujë dhe Ujëra të Zeza** nënkupton praktikat, metodat dhe procedurat që përputhen me sigurinë dhe kërkesat ligjore të cilat arrihen duke ushtruar atë shkallë së zotësisë, kujdesit, maturisë dhe parashikimit e cila me arsye dhe në mënyrë të thjeshtë pritet që të ndërmerren në llojin e njejtë nga një Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza me zotësi dhe përvojë i angazhuar në rrethana të njejtë apo të ngjajshme me ato që i takojnë Bashkimit Evropian (BE);

**Regjion** nënkupton një zonën e definuar nga Plani i Konsolidimit i cili përfshin një Komunë dhe tërësinë apo një pjesë të Komunave tjera;

**Rregullatori** nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina. Gjithashtu referohet si “Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (“ZRRUM”) e krijuar nën Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë apo organizatë e saj pasardhëse;

**Shërbimet e Ujërave të Zeza** nënkupton mbledhjen, hudhjen, dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe kanalizimit dhe rrjetet operuese dhe stabilizimet për atë qëllim.

**Shërbimet e Ujit** nënkupton marrjen, përpunimin, dhe shpërndarjen e ujit për konsum njerëzor dhe operimin e rrjetit dhe objekteve për atë qëllim; dhe

**Standardet Minimale të Shërbimit** nënkupton nivelin minimal të shërbimeve të përcaktuar nga Rregullatori në Rregullën mbi Standardet Minimale të Shërbimit për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë;

**Standardi i Shërbimeve** nënkupton, në lidhje me cilindo Shërbim, standardet e shërbimeve të cilat janë të aplikueshme për atë Shërbim;

**Statutet** nënkupton aktet nënligjore të aprovuara nga Bordi Mbikqyrës i Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat definojnë, në mes të tjerash, statusin legal dhe përgjegjësinë; veprimtaritë e kompanisë; përbërjen e Bordit Mbikqyrës; zyrtarët menaxhues dhe detyrat; dhe menaxhmentin financiar;

**Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit** nënkupton taksën zyrtare të përfundueshme ose pagesën për Rregullatorin nga Aplikuesi për Licencë në momentin e dorëzimit të Aplikacionit të kompletuar për Licensën e Shërbimit;

**Taksa e Licencës së Shërbimit** nënkupton taksën vjetore të pagueshme për Rregullatorin nga Poseduesi i Licensës sipas kësaj Rregulle;

**Tarifa e Shërbimit** nënkupton cilëndo vlerë, ngarkesë ose taksë të Ofruesit të Shërbimeve në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të tij ndaj Konsumatorëve;

**Uji me Shumicë** nënkupton ujin i cili nuk është i përpunuar në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për konsum njerëzor;

**Zona e Shërbimit** nënkupton, në lidhje me Licensën për Shërbim, Regjionin apo Komunën brenda të cilit Ofruesi Përkatës i Shërbimit mund të ofrojë shërbimet e tij;

## Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë definuar në mënyrë të posaqme dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të kenë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Hyrjen e kësaj Rregulle dhe/ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull do të interpretohen sipas kuptimit të cilitdo Rregulli të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me pushtetin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas;
- (d) Fjalët që përdoren në cilëndo gjini do të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse shprehimisht nuk është thënë ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të këtyre Rregullave

## **PJESA II: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË LICENSËS SË SHËRBIMEVE**

### Neni 6: Aplikueshmëria

Të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë që tani ofrojnë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose Furnizimin e Ujit me Shumicë duhet të aplikojnë te Rregullatori për Licensë të Shërbimit sipas dispozitave të kësaj Rregulle.

### Neni 7: Afati i Licensës së Shërbimit

Licenca e Shërbimit do të lëshohet për periudhë jo më të shkurtë se një (1) vit dhe jo më të gjatë se pesë (5) vite.

### Neni 8: Numri i Licensave për Shërbime

Jo më shumë se një Licensë e Shërbimit do ti lëshohet cilëndo Ndërmarrje Publike që ofron Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose të Furnizimit të Ujit me Shumicë.

### Neni 9: Shpenzimet për Marrjen e Licencës së Shërbimit

- 9.1 Të gjitha shpenzimet që shkaktohen nga Aplikuesi për Licencën e Shërbimit, lidhur me aplikimin për marrjen e Licencës së Shërbimit, duke përfshirë edhe Taksën e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit, do të jenë përgjegjësi vetëm e Aplikuesit për Licencën e Shërbimeve.
- 9.2 Në Tarifat e Shërbimeve Ofruesi i Shërbimeve do të përfshijë shumën që paguan për Taksën e Aplikacionit për Licencën të Shërbimit.

## **PJESA III: APLIKIMI PËR LICENSË TË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 1: Sistemi i Aplikimit për Licensë të Shërbimit**

#### **Neni 10: Afatet për Aplikimin për Licencë të Shërbimit**

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që ofrojnë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose të Furnizimit të Ujit me Shumicë duhet të dorëzojnë Aplikacionin e kompletuar për Licensë të Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.

#### **Neni 11: Parashtrimi i Kërkesës për Licencë të Shërbimit**

Të gjitha Aplikacionet për Licencë të Shërbimit duhet të dorëzohen në tri kopje të Rregullatori (një origjinal dhe dy kopje) sipas udhëzimeve të dhëna në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit të përfshirë në Shtojcën e kësaj Rregulle.

#### **Neni 12: Aprovimi i Bordit Mbikqyrës**

- 12.1 Të gjitha Aplikacionet për Licencë të Shërbimit duhet të aprovohen nga Bordi Mbikqyrës i Ndërmarrjes Publike para se të dorëzohen te Rregullatori.
- 12.2 Aprovimi nga Bordi Mbikqyrës i përcaktuar në nën-nenin 12.1 duhet të jipet në formë të letrës ë lëshuar nga Bordi Mbikqyrës dhe duhet të bashkangjitet në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit.

#### **Neni 13: Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit**

- 13.1 Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do të depozitohet në xhirollogarinë e caktuar bankare të hapur nga Rregullatori në cilëndo bankë të Licencuar që punon në Kosovë.
- 13.2 Shuma e caktuar për t'u paguar Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit me propozimin e Rregullatorit duhet të jetë e përcaktuar kohë pas kohe nga Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe do të shënohet në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit.

#### **Neni 14: Aprovimi i Deklaratave Financiare nga Agjensia Kosovare e Mirëbesimit**

- 14.1. Zyrtari i lartë financiar i AKM-së ose ndonjë Person të cilit i është dhënë mandati dhe është i autorizuar për të bërë një gjë të tillë nga AKM-ja, do të aprovojë të gjitha deklaratat financiare të dorëzuara nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit te Rregullatori me qëllim të marrjes së Licencës së Shërbimit.
- 14.2. Aprovimi nga AKM-ja i deklaratave financiare të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit do të evidentohet me një dokument të nënshkruar nga zyrtari i lartë financiar i mandatuar dhe i autorizuar ose Personi i mandatuar dhe i autorizuar nga AKM-ja të bëjë një gjë të tillë .

### Neni 15: Dëftesa nga Rregullatori

Rregullatori, do ti dërgojë Aplikuesi për Licencë te Shërbimit, jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune pas pranimit të Aplikacionit për Licencë te Shërbimit:

- (a) Një njoftim që konfirmon datën dhe kohën e pranimit të Aplikacionit për Licencë te Shërbimit edhe pse ajo letër konfirmuese nuk do të detyrojë Rregullatorin të pranojë dhe aprovojë dokumentet e dërguara me Aplikacionin për Licencë te Shërbimit e as nuk do të paraqesë evidencë për çfarëdo certifikimi të saktësisë dhe kompletimit të këtyre dokumenteve; dhe
- (b) Faturën për fondet e dërguara nga Aplikuesi për Licencë te Shërbimit për Taksën e Aplikacionit për Licencë e Shërbimit.

## **Kapitulli 2: Informatat e Nevojshme**

### Neni 16: Informatat e Përgjithshme për Identifikim

Aplikuesi për Licencë te Shërbimit në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do të ofrojë informatat e përgjithshme për identifikim:

- (a) Identifikimi i Ofruesit të Shërbimeve: Do të ipet emri, adresa, numrat e telefonit, dhe adresa elektronike (e-mail) e Ofruesit të Shërbimeve;
- (b) Shërbimet e Ofruara: Furnizimin me ujë, përpunimin, shpërndarjen; mbledhjen e ujërave të zeza, përpunimin, zbrazjen; furnizimin e ujit me shumicë;
- (c) Personi kontaktues për Aplikacionin për Licencë e Shërbimit.

### Neni 17: Zona e Shërbimeve, Banorët e Shërbyer

Aplikuesi për Licencë te Shërbimit në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do të ofrojë informatat për Zonën e Shërbimit dhe Konsumatorët:

- (a) Identifikimi i Zonës së Shërbimeve: Zona e Shërbimit, duke përfshirë edhe emrin(at) e Komunës(ave) ku ofrohen shërbimet në datën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë te Shërbimit si dhe do të shënohen kufijtë gjeografik.
- (b) Zonat e Shërbimeve në të Ardhmen: Aplikuesi për Licencë të Shërbimit do të shënojë emrat e të gjitha Komunave, nëse ka ndonjë, të cilat do të bëhen pjesë e Zonës së tij të Shërbimit sipas Planit të Konsolidimit.
- (c) Fshatrat dhe Vendbanimet: Duhet të ofrohen emrat e Fshatrave dhe Vendbanimeve të shërbyera në datën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit.
- (d) Konsumatorët që u ofrohen shërbimet: Një vlerësim i numrit të Konsumatorëve të shërbyer nga Aplikuesi për Licencë te Shërbimit në kohën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë te Shërbimit dhe sipas kategorive vijuese:
  - i. Konsumatorët e Amvisërisë;

- ii. Konsumatorët Komercial/Industrial; dhe
- iii. Konsumatorët Institucional

#### Neni 18: Burimi i Ujit, Përpunimi dhe Deponimi në Rezervoare

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit në datën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit në pjesën përkatëse të formularit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do të ofrojë informatat vijuese:

- (a) Burimin(et) e Ujit: Lokacionin(et), kategorinë (nëntokësorë ose sipërfaqësorë); llojin (pus, burim, liqen, lum); dhe të jap vlerësimin e sasisë së marrur në ditën mesatare (në metër kub).
- (b) Metodat e Përpunimit dhe Objektet: Lokacionet e objekteve për përpunim; llojin (koagulimin; filtrimin; dezinfektimin) dhe kemikaljet e shfrytëzuara; kapacitetin mesatar dhe maksimal ditor (në metër kub).
- (c) Ruajtja e Ujit të Përpunuar në Rezervoare: Lokacionet; lloji (i ngritur, në nivel të tokës, nëntokësor); materialet (beton, çelik, (lesh xhami) fiqe qelqi) dhe kapaciteti (në metër kub).

#### Neni 19: Sistemi i Shpërndarjes së Ujit

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit në datën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit në pjesën përkatëse të aplikacionit do të ofrojë informatat vijuese:

- (a) Kyçjet: Numrin e kyçjeve për shërbime;
- (b) Ujëmatësit e Konsumatorëve: Sipas kategorisë së konsumatorëve, rradhiten numrat e ujëmatësve, madhësia, dhe përqindja e vlerësuar që funksionon;
- (c) Shkalla e Mbulimit me Shërbime: Përqindja e vlerësuar e popullatës që marrin shërbime të ujit; numri i fshatrave rural që shërbehen me ujë;
- (d) Disponueshmëria e Shërbimit: Numri i orëve në ditët normale të shërbimit si dhe numri i ditëve gjatë javës kur ka ujë në dispozicion.

#### Neni 20: Grumbullimi dhe Derdhja e Ujërave të Zeza

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit në datën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit në pjesën përkatëse do të ofrojë informatat vijuese:

- (a) Mbledhja e Ujërave të Zeza: Numri i lidhjeve sipas kategorive: amvisëri dhe jo-amvisëri;
- (b) Shkalla e Mbulimit me Shërbime: Përqindja e vlerësuar e popullatës që marrin shërbime për ujëra të zeza; numri i fshatrave rural që u ofrohen shërbimet e ujërave të zeza;
- (c) Derdhja e Ujërave të Zeza: Lokacioni(et) ku ujërat e zeza zbrazen nga sistemi për grumbullimin e ujërave të zeza; numri i vlerësuar i njerëzve që jetojnë dhe punojnë përbrenda 200 metrave nga pikat e derdhjes.

#### Neni 21: Personeli

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit në datën e dorëzimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit, në pjesën përkatëse të aplikacionit duhet të ofrojë informatat vijuese:

- (a) Të punësuarit: Numrin total të punësuarve me orar të plotë dhe me gjysëm orari sipas funksioneve në administratë, komercial, financa, operime dhe mirëmbajtje dhe aktivitetet për Ujë dhe Ujëra të Zeza ose të dyjat;
- (b) Skema Organizative: Organogrami që tregon strukturën organizative duke filluar nga Bordi Mbikqyrës deri të njësitë më të vogla organizative duke përfshirë edhe zyrat njësi.

#### Neni 22: Tarifat e Shërbimit

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit do të ofrojë listën Tarifave të ndyshme të Shërbimit dhe taksat që janë në fuqi në datën kur është dorëzuar Aplikacioni për Licencë të Shërbimit.

#### Neni 23: Përvoja Paraprake e Punës

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit në pjesën përkatëse të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit do të ofrojë një përshkrim të përmbledhur të së kaluarës dhe përvojës së tij në ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose të Furnizimit të Ujit me Shumicë.

### **Kapitulli 3: Dokumentacioni i Nevojshëm Dëshmues**

#### Neni 24: Biografia e Personelit Menaxhues

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit do të:

- (a) Dorëzojë emrat e Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës, Drejtorit Menaxhues, Zyrtarit të Lartë Financiar, Inxhinierit të Lartë Menaxhues, Menaxherit për Shërbime ndaj Konsumatorëve dhe Menaxherëve të tjerë të Lartë të identifikuar me Statut; dhe
- (b) Dorëzojë, së bashku me Aplikacionin e kompletuar për Licencë të Shërbimit, biografinë e personelit menaxhues të lartë-përmendur sipas formatit të cekur në Shtojcën e kësaj Rregulle.

#### Neni 25: Autorizimi nga Komuna ku ofrohen Shërbimet

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit, së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit, duhet të dorëzojë dëshminë e dokumentuar se Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që aplikon për Licencë të Shërbimit ka lidhë ose ka parashtruar kërkesën për të lidhur Marrëveshjen për Shërbime me Komunën që i ofrohen shërbimet. Dëshmia e dokumentuar mund të jetë në formë të:

- (a) Marrëveshjes për Shërbime të nënshkruar nga Komuna dhe Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza; ose
- (b) Letra nga Bordi Mbikqyrës i Aplikuesit për Licencë të Shërbimit e dorëzuar në Komunë me të cilën dërgohet drafti i Marrëveshjes për Shërbime dhe caktohet takimi për ta diskutuar dhe nënshkruar.

#### Neni 26: Autorizimi për të Nxjerrë Ujë ose për të Zbrazur Ujërat e Zeza

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit, së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit do të dorëzojë dëshminë e dokumentuar se ka marrë autorizimin nga MMPH ose ka bërë kërkesën për autorizim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (“MMPH”) për nxjerrjen eujit si dhe për trajtimin dhe derdhjen e ujërave të zeza. Dëshmia e dokumentuar mund të jetë në formë të:

- (a) Autorizimit me shkrim nga MMPH-ja; ose
- (b) Letër nga Bordi Mbikqyrës të MMPH-ja duke kërkuar autorizim; ose
- (c) Letër nga Bordi Mbikqyrës të MMPH-ja dhe ZRRUM-ja duke përshkruar burimin e ujit; dhe
- (d) Letër nga Bordi Mbikqyrës të MMPH-ja dhe ZRRUM-ja duke përshkruar lokacionin për deponimin e ujërave të Zeza.

#### Neni 27: Dokumentet Afariste

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit do të dorëzojë dokumentet afariste si në vijim:

- (a) Kopjen e Statutit ose të dokumenteve tjera themeluese që themelojnë Ndërmarrjen Publike; dhe
- (b) Kopjen e Certifikatës për Regjistrimin e Biznesit që është në fuqi dhe valide e lëshuar nga UNMIK-u për Aplikuesin për Licencë të Shërbimit; dhe
- (c) Kopjen e Certifikatës për Regjistrimin e TVSH-së të lëshuar për Aplikuesin për Licencë të Shërbimit; dhe
- (d) Konfirmimin me shkrim nga zyrtari i lartë financiar për Aplikuesin për Licencë të Shërbimit se të gjitha pagat e punëtorëve janë paguar dhe janë aktuale sipas marrëveshjes me punëtorët në fjalë; dhe se tatimi mbi të ardhurat dhe pensionet e paguara të depozituara nga punëdhënësi në emër të punëtorëve janë dërguar në autoritetet e caktuara fiskale të Kosovës; dhe
- (e) Një kopje të pakos të fundit të deklaratave financiare, të revizionuara nëse janë dispozicion. Deklaratat financiare do të certifikohen nga AKM-ja dhe të mbulojnë periudhën raportuese më të afërt të kompletuar prej dymbëdhjetë (12) muajve paraprak nga data në të cilën është dorëzuar aplikacioni për Licencë. Për periudhat në mes të tri (3) muajve dhe njëmbëdhjetë (11) muajve para dorëzimit, Aplikuesi për Licencë të Shërbimit mund të dorëzojë deklaratat e përvizionuara financiare të cilat janë të certifikuara nga AKM-ja. Nëse Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është shoqëri me përgjegjësi të përgjithshme, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ose shoqëri aksionare, ose kompani me përgjegjësi të kufizuar deklaratat financiare do të certifikohen nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues dhe Zyrtari i Lartë Financiar; dhe
- (f) Kopjen e deklaratave bankare për të gjitha llogaritë bankare të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit për periudhën që mbulon gjashtë (6) muaj të plotë paraprak prej datës në të cilën është dorëzuar Aplikacioni për Licencë të Shërbimit.

#### Neni 28: Dokumentet për Obligime ndaj Ndërmarrjeve Shërbyese dhe Obligime Tatimore

- (a) Dëshmia e dokumentuar e cila qartë demonstroi se Aplikuesi për Licencë të

Shërbimit ka paguar faturat për rrymë elektrike, mbeturinat e ngurta, dhe telefon. Dëshmia e dokumentuar mund të jetë në formë të Faturës së vulosur me "e paguar në tërësi" nga zyrtari i autorizuar i ndërmarrjes që ofron shërbimet publike. Në rast se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit nuk ka paguar borxhet e vjetra ose faturat aktuale, duhet të ofrohet shpjegimi për të arsyetuar, si dhe shuma e borxhit dhe përshkrimi i masave korrigjuese që duhet të ndërmerren; dhe

- (b) Duhet të prezantohet dëshmia e dokumentuar e cila qartë demonstroi se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është i rregullt ndaj detyrimeve të tij për Faturat e tatimit mbi Pronën. Dëshmia e dokumentuar duhet të jetë në formë të Faturës për Tatimin mbi Pronën e vulosur me "e paguar në tërësi" nga zyrtari i autorizuar i Komunës përbrenda së cilës është i vendosur Aplikuesi për Licencë të Shërbimit. Në rast se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit nuk është i rregullt ndaj detyrimeve të tij për Tatimin mbi Pronën, duhet të ofrohet një shpjegim për të arsyetuar, si dhe shuma e borxhit dhe përshkrimi i masave korrigjuese; dhe
- (c) Dëshmia e dokumentuar që qartë demonstroi se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është i rregullt në pagesën e Faturave tjera të tatimeve për të cilat Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është i obliguar, duke përfshirë TVSH-në, Tatimin mbi të Hyrat dhe tatimet tjera të definuara më ligj dhe të pagueshme te autoriteti kompetent.

#### Neni 29: Dokumentet Tjera

Aplikuesi për Licencë të Shërbimit gjithashtu së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit do të dorëzojë hartën e Zonës së Shërbimit me perimetër të identifikuar qartë.

### **PJESA IV: SHQYRTIMI DHE LËSHIMI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT**

#### **Kapitulli 4: Shqyrtimi i Aplikacionit për Licencë të Shërbimit**

##### Neni 30: Shqyrtimi i Përgjithshëm i Aplikacionit për Licencë dhe Dokumentet e Bashkangjitura

Rregullatori do të procedojë me kompletimin e rishikimit (shqyrtimit) të përgjithshëm të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit të dorëzuar, si dhe të dokumenteve shoqëruese përkatëse si vijon:

- (a) Rregullatori do të sigurohet se Aplikacioni për Licencë të Shërbimit i dorëzuar nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është kompletuar në tërësi dhe se janë përfshirë informacionet dhe dokumentet e kërkuara. Rregullatori do të regjistrojë rezultatet e shqyrtimit në formularin që titullohet "Lista e Kontrollimit të Kompletimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit" e paraqitur në Shtojcën e kësaj Rregulle.
- (b) Rregullatori do të informojë me shkrim Aplikuesin për Licencë të Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimit të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit për secilën informatë që mungon ose është e pakompletuar dhe që Aplikacioni për Licencë të Shërbimit do të mbahet

pezull deri në atë kohë kur të ofrohen dokumentet ose informatat që mungojnë, për një periudhë që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike, pas së cilës Aplikacioni për Licencë e Shërbimit do ti kthehet Aplikuesit për Licencë te Shërbimit. Në rast se ndodhë një gjë e tillë shuma e plotë e Taksës për Aplikacionin për Licencë te Shërbimit do të konfiskohet dhe do të ngel tek Rregullatori.

#### Neni 31: Pamundësia për të Ofruar Informatën e Kërkuar

Aplikuesi për Licencë te Shërbimit do të ofrojë arsyetimin me shkrim lidhur me pamundësinë e tij për të ofruar cilëndo prej informatave dhe dokumenteve të kërkuara dhe të ofrojë një afat kohor me masat korrigjuese për rregullimin e situatës.

#### Neni 32: Shqyrtimi i Detajizuar i Aplikacionit për Licencë te Shërbimit dhe Dokumentet e Bashkangjitura

Menjëherë pas instancës kur Aplikacioni për Licencë te Shërbimit të konsiderohet i pranueshëm, brenda tridhjetë (30) ditëve të punës, Rregullatori do të vazhdojë të zbatojë dhe kompletojë një shqyrtim teknik me të thellë dhe më objektiv lidhur me:

- (a) Saktësinë dhe tërësinë e informatës së ofruar në Aplikacionin për Licencë te Shërbimit dhe në dokumentet përkatëse shoqëruese; dhe
- (b) Kapacitetin e menaxhmentit dhe aftësinë operative të Aplikuesit për Licencë te Shërbimit për të ofruar Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza në një nivel të pranueshëm të kualitetit, besueshmërisë dhe sigurisë me çmime të përballueshme për Konsumatorët dhe sipas kushteve ekzistuese ekonomike në Kosovë; dhe
- (c) Kapacitetin financiar të Aplikuesit për Licencë te Shërbimit për sa i përket mirëmbajtjes dhe vazhdimit të operimeve për periudhën që do të mbulohet nga Licenca e Shërbimit; dhe
- (d) Ndikimet e dhënies së Licencës së Shërbimit përkitazi me cilindo dokument ose informate që mungon duke pasur parasysh arsyetimet e ofruara nga Aplikuesi për Licencë te Shërbimit.

#### Neni 33: Kërkesa për informata plotësuese

Aplikuesi për Licencë te Shërbimit është i obliguar të bashkëpunojë me Rregullatorin që me përpikëri të ofrojë cilatdo informata dhe dokumente shtesë që në mënyrë të arsyeshme kërkohen nga Rregullatori për të vlerësuar në mënyrë të duhur Aplikacionin për Licencë te Shërbimit.

### **Kapitulli 5: Lëshimi i Licencës së Shërbimit**

#### Neni 34: Lëshimi i Licencës së Shërbimit

Rregullatori do të lëshojë Licencën e Shërbimit për Aplikuesin e suksesshëm të Licencës së Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data në të cilën është kompletuar shqyrtimi i detajizuar dhe rezultatet e shqyrtuara të jenë vlerësuar se janë të pranueshme për sa i përket Aplikuesit për Licencë te Shërbimit i cili:

- (a) Ka dërguar paratë për taksën për Aplikacionin për Licencë të Shërbimit; dhe
- (b) Ka dorëzuar formularin e kompletuar dhe dokumentet tjera të kërkuara për Aplikacionin për Licencë të Shërbimit; dhe
- (c) Ka demonstruar gjatë procesit të Aplikimit për Licencë të Shërbimit se ka ndershmëri financiare dhe kapacitet teknik dhe ekonomik për të mirëmbjatur dhe vazhduar punën në nivel që kërkohet në Kushtet e Licensimit të Shërbimeve; dhe
- (d) Ka demonstruar gjatë procesit të aplikimit se ka zotësitë elementare menaxhuese dhe përvojën për të ofruar shërbimet për ujë dhe ujëra të zeza sipas Standardeve të Shërbimeve të kërkuara në Kushtet e Licensimit të Shërbimeve; dhe
- (e) Ka demonstruar gjatë procesit të aplikimit se ka pajisje adekuate dhe mirëmbajtjen mekanike për të ofruar Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza të kërkuara në Kushtet e Licensimit; dhe
- (f) Ka marrë të gjitha lejet e nevojshme, pëlqimet dhe autorizimet tjera nga autoritetet e caktuara dhe është në pajtim me kërkesat e atyre lejeve, pëlqimeve ose autorizimeve.

## **PJESA V: LICENCA E SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 6: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit**

#### **Neni 35: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit**

Licencat e Shërbimit të lëshuara nga Rregullatori do të specifikojnë ose do të përfshijnë si në vijim:

- (a) Çertifikatën për Licencë të Shërbimit; dhe
- (b) Që Licenca e Shërbimit është e ripërtërishme dhe e transferueshme; dhe
- (c) Afatin për të cilin është lëshuar Licenca e Shërbimit; dhe
- (d) Emrin e Komunës(ave) që do të u ofrohen shërbimet, identifikimi i Zonave të Shërbimit si dhe përshkrimin e kufive gjeografik të Zonës së Shërbimeve; dhe
- (e) Tarifat të cilat Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet ti zbatojë; dhe
- (f) Kërkesat raportuese të cilat do të kërkohen që të zbatohen dhe të ofrohen nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit; dhe
- (g) Listën e objekteve dhe paisjeve për të cilat Aplikuesi për Licencë të Shërbimit ka autorizim për ti operuar sipas kushteve të Licencës së Shërbimit.

#### **Neni 36: Obligimet për Aplikuesit për Licencë të Shërbimit**

Licenca e Shërbimit e lëshuar nga Rregullatori për të gjithë Aplikuesit për Licencë të Shërbimit qartë do të identifikojë obligimet si në vijim:

- (a) Të jetë konform me të gjitha Kushtet e Licencës së Shërbimit të shënuara në Licensën e Shërbimit dhe në cilatdo kushte shtesë të veçanta që mund të kërkohen nga Rregullatori në Licencë të Shërbimit;
- (b) Paguajë Taksat e aplikueshme të Licencës së Shërbimit sipas afateve të

- specifikuara në Licencë të Shërbimit;
- (c) Ofrrojë dhe mirëmbajë Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza në nivel të Standardeve minimale të Shërbimeve të specifikuara në tërë Zonën e tij të dedikuar të Shërbimit;
  - (d) Të mbajë kapacitetet e tij menaxheriale, operative dhe teknike, dhe resurset për të operuar dhe mirëmbajtur objektet dhe të ofrojë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza;
  - (e) Të ruajë solvenitetin e vet financiar gjatë gjithë kohëzgjatjes së Licencës së Shërbimit;
  - (f) Të mbajë lejet dhe aprovimet e kërkuara nga agjencitë tjera sipas kërkesës;
  - (g) Rregullisht dhe pa përjashtim të faturojë të gjithë Konsumatorët që marrin Shërbime të Ujit dhe të Ujërave të Zeza ose që Furnizohen me Ujë me Shumicë; dhe
  - (h) Dorëzojë raportet Rregullatorit.

#### Neni 37: Detajet që janë Specifike për Aplikuesit e Caktuar për Licencë të Shërbimit

Në Licencë të Shërbimit që i lëshohet Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të caktuar nga AKM-ja që të kenë Autoritet Menaxhues mbi Ofruesit e tjerë të Ujit dhe Ujërave të Zeza sipas Planit të Konsolidimit, Rregullatori gjithashtu do të përfshijë si vijon:

- (a) Deklaratën që konfirmon se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit do të jetë i obliguar të pranojë përgjegjësinë e përgjithshme për dhënien Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Zonën e Shërbimeve aktualisht të mbuluar në mënyrë vetanake dhe zona të ardhshme, siq do të specifikohet nga AKM-ja, dhe
- (b) Deklarata që konfirmon se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit është përgjegjës për kordinimin dhe menaxhim të operimeve të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që do të jetë pjesë e Autoritetit të tij Administrativ, dhe
- (c) Deklarata që konfirmon se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit do të sigurojë standardizimin gradual të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza të ofruara në Zonat aktuale të Shërbimeve dhe ato në të ardhmen ku është teknikisht dhe financiarisht e realizueshme të bëhet një gjë e tillë; dhe
- (d) Emrat e Komunave që do të jenë nën përgjegjësinë dhe autoritetin e përgjithshëm të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit; dhe
- (e) Deklarata që konfirmon se Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet të lidhë marrëveshjen me Ofruesit e Shërbimeve të identifikuar nga AKM-ja dhe se kordinimi dhe menaxhimi i operimeve të këtyre Ofruesve të Shërbimeve janë vendosur drejtpërdrejt nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Ofruesit të Shërbimeve të caktuar nga AKM-ja pasi që ka Autoritetin Menaxhues.

### **Kapitulli: Taksa për Licencë të Shërbimit**

#### Neni 38: Taksa për Licencë të Shërbimit

38.1 Për secilin Posedues të Licencës së Shërbimit, Rregullatori do të përcaktojë

shumën totale të Taksës për Licencë te Shërbimit, shumën për secilin këst mujor, dhe metodën e pagesës.

- 38.2 Pagesa e Taksës për Licencë te Shërbimit është e pagueshme në këste të barabarta mujore në ditën e parë të punës së secilit muaj në vazhdim të datës në të cilën është lëshuar Licenca e Shërbimit.
- 38.3 Pasi që të lëshohet Licenca e Shërbimit, Rregullatori në baza vjetore do të llogaritë shumën totale të Taksës për Licencë te Shërbimit e cila do të jetë e caktuar dhe e pagueshme dhe do të informojë Poseduesin e Licencës së Shërbimit lidhur me atë Taksë për Licencë e Shërbimit.

## **PJESA VI: REFUZIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT**

### **Neni 39: Refuzimi i Kërkesës së Licencës së Shërbimit**

- 39.1 Rregullatori mund të refuzojë që të aprovojë Aplikacionin për Licencë te Shërbimit dhe kërkesën për të ripërtrirë Licencë të Shërbimit në bazë të:
- (a) Dështimit të Aplikuesit për Licencë e Shërbimit që të ofrojë informatat e kërkuara brenda kufijve të caktuar kohor;
  - (b) Një vlerësimi që shpie në konkludim se Aplikuesi për Licencë te Shërbimit nuk mund të ofrojë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza në nivelin e minimumit të Standardeve të Shërbimeve dhe në nivel të Tarifave të Shërbimit me një besueshmëri dhe siguri të kërkuar;
  - (c) Dështimi i Aplikuesit për Licencë te Shërbimit që të sigurojë autorizimet e nevojshme nga autoritetet tjera kompetente dhe autoritetet publike.
- 39.2 Nëse Regullatori refuzon të lëshojë ose të ripërtërijë Licencën e Shërbimit për Ofruesin e Shërbimeve, do ta informojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve në afat prej dhjetë (10) ditëve të punës, duke i dhënë arsyet për një vendim të tillë.

## **PJESA VII: PËRTËRIRJA DHE TRANSFERI I LICENCËS SË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 7: Ripërtërirja e Licencës së Shërbimit**

#### **Neni 40: Ripërtërirja e Licencës së Shërbimit**

Licencat e Shërbimit të lëshuara nën këtë Rregull mund të ripërtërihen në periudha të barabarta prej afateve të tyre origjinale ose afateve të ripërtërirja të mëparshme për një ose më shumë herë sipas vendimit të Rregullatorit.

#### **Neni 41: Aplikacioni për Ripërtërirjen e Licencës së Shërbimit**

- 41.1 Ofruesi i Shërbimeve duhet të parashtojë kërkesën për ripërtërirje se paku dy (2) muaj para skadimit të datës së Licencës së Shërbimit.
- 41.2 Aplikacioni për ripërtërirjen e Licencës së Shërbimit do ti nënshtrohet formaliteteve të njejta të vëna sikurse për Aplikimin e parë për Licencë te

Shërbimit dhe do të dorëzohet te Rregullatori (një origjinal dhe dy kopje) sipas udhëzimeve të dhëna në Shtojcën e kësaj Rregulle.

- 41.3 Rregullatori do të ripërtërijë Licencën e Shërbimit për Aplikuesin e suksesshëm të Licencës së Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data në të cilën është kompletuar shqyrtimi i detajzuar i aplikacionit për ripërtërirjen dhe rezultatet e shqyrtimit janë vlerësuar të jenë të pranueshme sa i përket Aplikuesit i cili ka:
- (a) paguar taksën e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit; dhe
  - (b) dorëzuar formularin e kompletuar dhe dokumentet tjera të kërkuara për Aplikacionin për Licencimin të Shërbimit; dhe
  - (c) demonstruar gjatë procesit të Aplikimit për Licencë e Shërbimit se ka plotësuar kushtet në Licencë të Shërbimit për të cilën është kërkuar ripërtërirja lidhur me
    - (i) ofrimin e shërbimit të pranueshëm në sasi, seriozitet, siguri, dhe shpenzime, ose ndërmerr veprime të mjaftueshme për të tejkaluar mungesën e shërbimeve, dhe
    - (ii) zgjerimin e shërbimeve gjatë gjithë Zonës së tij të Shërbimit; dhe
  - (d) Ka pranuar aprovimin me shkrim nga AKM-ja se operimet e tij janë në përputhje me Planin e Konsoliduar dhe synimet e tij; dhe
  - (e) Ka marrë të gjitha lejet e nevojshme, pëlqimet dhe autorizimet tjera nga agjensionet tjera dhe autoritetet kompetente.

## **Kapitulli 8: Transferi i Licencës së Shërbimit**

### Neni 42: Transferi i Licencës së Shërbimit

Licencat e Shërbimeve të lëshuara nën këtë Rregull nuk do të transferohen ose përndryshe të i ipen palës së tretë pa ndonjë pëlqim me shkrim nga Rregullatori.

## **PJESA VIII: NDRYSHIMET, NDËRPRERJA DHE REVOKIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 9: Ndryshimet në Licencë të Shërbimit**

#### Neni 43: E drejta e Rregullatorit të Ndryshojë, Plotësojë ose të Zëvendësojë

Rregullatori mund të ndryshojë, plotësojë ose zëvendësojë cilëndo Pjesë të Licencës së Shërbimit pas shqyrtimit dhe ta njoftojë së paku tridhjetë (30) ditë të punës Aplikuesin për Licencë të Shërbimit me shkrim. Informata e tillë do të deklarojë natyrën dhe zgjatjen e ndryshimeve të tilla, plotësimin ose zëvendësimin dhe kohën kur do të hyjnë në fuqi.

#### Neni 44: Shqyrtimi i Kualifikimeve të Drejtorit Menaxhues

Rregullatori do të shqyrtojë kualifikimet dhe përvojën e zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të emëruar nga Bordi Mbikqyrës i Ofruesit të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza për tu siguruar për kompetencën e tij teknike dhe do të përgjigjet me shkrim atij Bordi Mbikqyrës brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data kur të komunikohet

zëvendësimi i Drejtorit Menaxhues.

#### Neni 45: Informimi i Rregullatorit për Ndryshime Sinjifikative

- 45.1 Poseduesi i Licencës së Shërbimit do të informojë me shkrim Rregullatorin në detaje për cilindo ndryshim signifikativ nga detajet e dorëzuara ose të bashkangjitur në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit në afatin prej pesë (5) ditëve të punës.
- 45.2 Rastet në vijim konsiderohen, pa kufizime, si përbërëse të ndryshimeve signifikative të situatës së Aplikuesit për Licencë të Shërbimit prej asaj të paraqitur në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit:
- (a) Ndryshimet e dukshme të bëra ose anulimet, shuarjet ose refuzimet e lëshimit ose ripërtëritjes të çfarëdo leje, pëlqime ose autorizime të marrura nga agjencitë tjera dhe/ose autoritetet kompetente;
  - (b) Zgjerim i dukshëm ose zvogëlim i kapaciteteve të objekteve të shfrytëzuara për dhënie të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;
  - (c) Ndryshimet e dukshme në shtrirjen e Zonës së propozuar të Shërbimeve;
  - (d) Ndryshimet e dukshme në gjendjen e mirë ekonomike dhe financiare të Aplikuesit për Licencë të Shërbimit;
  - (e) Zvogëlim i dukshëm ose rritje në pasuritë dhe/ose detyrimet e Aplikuesit për Licencë të Shërbimit;
  - (f) Ndryshimet në pronësinë efektive dhe/ose kontrollin administrues mbi Aplikuesin për Licencë të Shërbimit.

### **Kapitulli 10: Ndërprerja ose Revokimi i Licencës së Shërbimit**

#### Neni 46: Ndërprerja e Licencës së Shërbimit

Licenca e Shërbimit do të ndërpritet në:

- (a) Ditën e fundit e periudhës për të cilën është lëshuar; ose
- (b) Datën në të cilën Licenca për Shërbim është anuluar nga Rregullatori; ose
- (c) Datën në të cilën është hequr dorë nga Licenca e Shërbimit.

#### Neni 47: Revokimi i Licencës së Shërbimit

- 47.1 Rregullatori mund të revokojë Licencën e Shërbimit nëse Aplikuesi për Licencë të Shërbimit dështon të jetë në përputhje me afatet dhe kushtet e specifikuar në Licencë të Shërbimit.
- 47.2 Rregullatori do të informojë me shkrim Aplikuesin për Licencë të Shërbimit lidhur me arsyet për revokim dhe do të i lejojë Aplikuesi për Licencë të Shërbimit të përgjigjet brenda dhjetë (10) ditëve të punës.
- 47.3 Aplikuesi për Licencë të Shërbimit mund të bëjë ankesë në pajtim me Nenin 57.

#### Neni 48: Heqja dorë nga Licenca e Shërbimit

- 48.1 Aplikuesi për Licencë të Shërbimit mund të heq dorë nga Licenca e tij e Shërbimit duke e njoftuar me shkrim Rregullatorin gjashtë (6) muaj më herët.
- 48.2 Njoftimi me Shkrim në Nenin 48.1 duhet të nënshkruhet nga Bordi Mbikqyrës i Ofruesit të Shërbimeve që heq dorë nga Licenca e Shërbimit.

## **PJESA IX: MARRËVESHJA PËR LICENCË TE SHËRBIMIT**

### Neni 49: Marrëveshja për Licencë të Shërbimit

- 49.1 Rregullatori mund të lidhë marrëveshje me shkrim me cilindo prej Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza me qëllim të ndryshimit, ndërrimit dhe/ose plotësimit të cilësdo Licencë të Shërbimit të krijuar nën këtë Rregull.
- 49.2 Marrëveshja për Licencë të Shërbimit mund të lidhet duke i dhënë cilatdo kushte precedente të përcaktuara nga Rregullatori dhe të propozuara për Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, duke përfshirë, pa kufizime, lidhjen e marrëveshjeve tjera që lidhen me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mbi:
- (a) Lëshimin, ripërtërirjen, zgjerimin, ndryshimin, ndërrimin dhe plotësimin e Standardeve të Shërbimeve;
  - (b) Krijimin, shqyrtimin dhe/ose modifikimin e Tarifave të Shërbimeve;
  - (c) Zgjerimin e fushës territoriale të Zonës së Shërbimeve;
  - (d) Zgjerimin, rehabilitimin kryesor ose riparimin e Rrjetëve të Ujit;
  - (e) Krijimin, ndërrimin, zgjerimin, modifikimin dhe/ose plotësimin e cilësdo dispozitë lidhur me Konsumatorët që janë të paraqitura në Rregullin mbi Kartën e Konsumatorëve të lëshuar, ndryshuar, modifikuar dhe/ose plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 49.3 Licencat e Shërbimit që do të jenë objekt i Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit, kursesi, nuk duhet të jenë më pak strikte ose e më të rrepta se sa Licenca e Shërbimit e vënë nën këtë Rregull e ndryshuar dhe/ose e plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 49.4 Për mënjanimin e dyshimit, Ofruesit e Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza kanë të drejtë por nuk janë të obliguar ti propozojnë Rregullatorit të lidhin Marrëveshje për Licencë të Shërbimit në pajtim me dispozitat e Neni 50.

### Neni 50: Negociatat e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit

- 50.1 Ofruesi i Shërbimeve që dëshiron të lidhë Marrëveshje për Licencë të Shërbimit do të dorëzojë Rregullatorit kërkesën me shkrim duke kërkuar hapjen e negociatave për të hyrë në një marrëveshje të tillë duke i justifikuar arsyet se pse konsiderojnë se interesi publik dhe të drejtat e tyre legjitime dhe pritjet ligjore do të shërbeheshin më së miri nëse Rregullatori do të pranojë lidhjen e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit.
- 50.2 Rregullatori do të jep përgjigje me shkrim brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e pranimit të komunikimit të referuar më lartë, se ose pajtohet të hyjë në negociatën për Marrëveshjen për Licencë të Shërbimit ose refuzon një gjë të tillë.

- 50.3 Nëse Rregullatori vendosë të refuzojë të fillojë negociatat për të lidhur Marrëveshjen për Licencë të Shërbimit, do të ofrojë arsyet e veta lidhur me refuzimin.
- 50.4 Nëse Rregullatori pajtohet të fillojë negociatat për të hyrë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit, gjithashtu do të i jep Ofruesit të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza një periudhë të arsyeshme kohore, në çdo rast jo më pak se (30) tridhjetë ditë të punës, për ti lejuar Ofruesit të Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza ti dorëzojë Rregullatorit propozimin e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit.
- 50.5 Brenda dhjetë (10) ditëve të punës prej marrjes së draftit të Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit, Rregullatori do ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për caktimin e takimit të parë për të filluar me negociata për marrëveshjen.
- 50.6 Gjithashtu Rregullatori mund të përcaktojë periudhën kohore maksimale për përfundimin të negociatave për të lidhë Marrëveshjen për Licencë të Shërbimit, e cila nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) ditë të punës nga data e caktimit të takimit të parë negociues në pajtim me nën-nenin 50.5.
- 50.7 Për mënjanimin e dyshimit, Rregullatori ka të drejtë por nuk është i obliguar të lidhë Marrëveshjen për Licencë të Shërbimit dhe, prandaj, ose refuzimi i tij të hyjë në ato negociata për atë marrëveshje ose cilido dështim për të kompletuar në mënyrë të suksesshme negociatat në fjalë, konsiderohen si vendime kontraktuese dhe jo si akte administrative ose vendime që i nënshtrohen cilitdo shqyrtim administrativ dhe/ose juridik.

#### Neni 51: Lidhja e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit

- 51.1 Në rast të përfundimit të suksesshëm të negociatave të drejtuara në pajtim me Nenin 50, Rregullatori dhe Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërve të Zeza do të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Licencë të Shërbimit.
- 51.2 Marrëveshja për Licencë të Shërbimit do të nënshkruhet në tri versione në secilën prej gjuhëve zyrtare që janë në përdorim në Kosovë si në vijim:
- (a) Shqip;
  - (b) Sërbisht;
  - (c) Anglisht.
- 51.3 Në rast të mospërputhjeve në mes të cilitdo verzion në të cilin është nënshkruar Marrëveshja për Licencë të Shërbimit, verzioni në gjuhën Angleze do të mirret si bazë.
- 51.4 Përveç nëse informata dhe/ose dokumenti mund të konsiderohet që përmbajnë çfarëdo informate të privilegjuar ose të besueshme që Rregullatori mund ti arsyetojë në vendim me shkrim, Marrëveshja për Licencë të Shërbimit, Shtojcat e saj dhe të gjitha informatat e përdorura për negociata dhe lidhjen e asaj marrëveshjeje do të publikohen ose të bëhen publike me mjetet të cilat Rregullatori mund ti përcaktojë kohë pas kohe dhe ti vë në dispozicion në çdo kohë për konsultim publik.
- 51.5 Për çfarëdo ndryshime, ndërrime, modifikime ose dispozita plotësuese përkitazi me Marrëveshjet për Licencë të Shërbimit duhet të këtë pëlqim të Rregullatorit dhe nënshkrimin e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe duhet të

lidhen me shkrim, të publikohen dhe të bëhen publike në pajtim me dispozitat e nën-neneve të lartëshënuara në këtë Nen.

#### Neni 52: Karakteri Ligjor dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes për Licencë të Shërbimit

- 52.1 Marrëveshja për Licencë të Shërbimit konsiderohet si kontratë administrative për të gjitha qëllimet ligjore të menduara duke qenë që Rregullatori është i obliguar të bëjë negociata, të lidhë dhe të ekzekutojë një marrëveshje të tillë me mbikqyrje strikte të parimeve të përgjithshme ligjore, rregullave dhe procedurave me të cilat administrohet ushtrimi i të drejtave të posaçme dhe detyrave të autoritetit publik.
- 52.2 Marrëveshja për Licencë të Shërbimit, si akt ligjor bilateral, është i obligueshëm në mënyrë të ligjshme, i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në pajtim me kushtet e veta për të dyja palët dhe mund të ndryshohet, zgjerohet, modifikohet, plotësohet, rishikohet dhe/ose të ndërpritet vetëm në frymën e dispozitave të saja dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

#### Neni 53: Përmbushja e Kushteve të Licencës së Shërbimit

Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza janë të obliguar të respektojnë dhe të jenë në pajtim me Licencën e Shërbimit të përcaktuara në vija të përgjithshme me këtë Rregull:

- (a) Gjatë kohës derisa negociatat për të lidhë Marrëveshjen për Licencë të Shërbimit presin deri në datën e hyrjes në fuqi të asaj marrëveshjeje;
- (b) Menjëherë pas ndërprerjes, anulimit, revokimit dhe/ose skadimit të Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit përderisa nuk është arritur pajtimi për të mbijetuar çfarëdo të drejta dhe obligime që përmban Marrëveshja për Licencën të Shërbimit edhe pasi të jetë ndërpre të jetë në fuqi dhe efekt të plotë për çfarëdo shkak ligjor;
- (c) Në të gjitha aspektet ku Marrëveshja për Licencë të Shërbimit nuk përcakton ndryshe ose në të gjitha aspektet që nuk parashihen në mënyrë të veçantë në një marrëveshje të tillë.

### **PJESA X: VËNIA NË FUQI, GJOBAT DHE ANKESAT**

#### **Kapitulli 11: Vënia në Fuqi e Kushteve të Licencës së Shërbimit**

##### Neni 54: Vënia në Fuqi e Kushteve të Licencës së Shërbimit

- 54.1 Rregullatori do të monitorojë pajtueshmërinë me Kushtet e Licencës së Shërbimit të përcaktuara me këtë Rregull në bazë të raporteve të rregullta të dërguara nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza siç përcaktohet nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me Nenin 55 të poshtëshënuar.
- 54.2 Rregullatori gjithashtu do të monitorojë pajtueshmërinë me këtë Rregull me anë të inspektimeve dhe analizave dhe nga raportet e dërguara nga subjektet tjera dhe autoritetet publike.

## **Kapitulli 12: Raportet dhe Shënimet për Kushtet e Licencës së Shërbimit**

### Neni 55: Raportet për Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 55.1 Secili Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përgatisë dhe t'ia dorëzojë raportet Rregullatori në formën e parashkruar dhe brenda intervaleve të specifikuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 55.2 Secili Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do ti dorëzojë Rregullatorit, jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik në përmyllje të vitit të mëparshëm kalendarik, Raportin Vjetor në formatin të cilin Rregullatori e specifikon kohë pas kohe.
- 55.3 Bilanset tre-mujore që nuk janë të revizionuara do të dorëzohen deri në ditën e 15-të të muajit vijues pas përfundimit të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor në formatin që është në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht dhe rregullat e kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi në Kosovë.
- 55.4 Ndryshimi i Kontrollit të Menaxhimit ose Raporti i Pronësisë do të dorëzohet së paku një herë në vit jo më vonë se 15 janari i secilit vit kalendarik të dhënë ose brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data ku ka ndodhur ndonjë fakt relevant që do të ndikonte në cilindo ndryshim në kontrollin e menaxhimit ose pronësinë e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.
- 55.5 Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë të punës nga data kur ka ndodhë cilido ndryshim material në cilindo fakt ose informatë që përmban dokumenti i cili e ka shoqëruar Kërkesën për Licencë e Shërbimit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të dërgojë një verzion me të dhënat e fundit të atij dokumenti ose do ti dërgojë Rregullatorit verzionin me informacionet e fundit në formatin të cilin mund ta specifikojë Rregullatori kohë pas kohe.
- 55.6 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të njoftojnë me shkrim Rregullatorin për cilatdo fakte ose situata të cilat kanë ngjarë dhe prodhuar rezultate që Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të mos jetë më në gjendje të jetë në pajtim dhe/ose ka dështuar të jetë në pajtim me kushtet dhe konditat të atyre lejeve zyrtare, autorizimeve ose pëlqimeve nga autoritetet tjera kompetente të konsideruara si esenciale për dhënien e Licencës së Shërbimit në pajtim me këtë Rregull.
- 55.7 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza janë të obliguar ti raportojnë me shkrim Rregullatorit cilatdo fakte ose situata të cilat aktualisht ose potencialisht mund të prekin pozitën e tyre të mirë ekonomike dhe financiare ose solvenitetin, kapacitetin e tyre Administrativ për të ofruar Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose disponueshmërinë e gatshme të ekspertizës teknike dhe resurseve që nevojiten për dhënien e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në standardet e përcaktuara nga Rregullatori, duke përfshirë, pa kufizime, kurdo qoftë:
- (a) Cilido interes i sigurisë për asetet që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza bëhet i zbatueshëm;
  - (b) Ndonjë Person merr në posedim, ose ndonjë proces është imponuar, vënë në jetë ose ngritur padia ndaj ndonjë asemi që ka të bëjë me ofrimin Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

- (c) Çfarëdo veprimi ose procedime ligjore kanë filluar ose hapa tjerë janë ndërmarrë për bankrotimin ose likuidimin e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose te deklarimin e falimentimit të tij.
- 55.8 Lokacioni dhe Mbajtja e Shënimeve: Të gjitha shënimet do të mbahen në zyren kryesore të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe do të jenë në dispozicion gjatë orarit të rregulltë të punës për tu kontrolluar nga Rregullatori.
- 55.9 Periudha e Mbajtjes së Shënimeve dhe Raporteve: Të gjitha shënimet dhe raportet e parapara në këtë Nen duhet të organizohen dhe të mbahen nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza së paku 2 (dy) vite kalendarike nga data kur ato janë përgatitur së pari ose u është caktuar afati, përveç nëse ndonjë ligj tjetër i aplikueshëm e përcakton se ato duhet të mbahen për ndonjë periudhë më të gjatë kohore në të cilin rast periudha e fundit e mbajtjes do të aplikohet.

### **Kapitulli 13: Kundërvajtjet dhe Dënimet**

#### Neni 56: Kundërvajtjet dhe Dënimet

- 56.1 Dështimi për të qenë në pajtueshmëri gjatë gjithë kohës me të gjitha Kushte e Licencës së Shërbimit të përcaktuara nën këtë Rregull do të merret si kundërvajtje dhe do të ndëshkohen Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza me gjobitje në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Ujërave të Zeza
- 56.2 Gjobat për shkelje të cilësdo prej Kushteve të Licencës së Shërbimit gjithashtu do të vihen në pajtim me procedurat e krijuara për vënien e gjobave dhe me cilatdo Rregulla tjera procedurale të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

### **Kapitulli 14: Ankesat**

#### Neni 57: Ankesat

- 57.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të ankohet te Komisioni Shqyrtues i themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për çfarëdo vendime konkrete të Rregullatorit të ndërmarrë për ndonjë çështje relevante, duke përfshirë, pa kufizime:
- (a) Nxjerrjen, ndërrimin, modifikimin, ndryshimin, plotësimin, ripërtërirjen, zgjerimin ose modifikimin e Licencës së Shërbimit;
  - (b) Revokimin, deklarimin e ndërprerjes ose pezullimin e cilësdo Licencë të Shërbimit të përcaktuar nga Rregullatori me këtë Rregull;
  - (c) Përcaktimin ose vënien në jetë të cilitdo prej Kushteve të Licencës së Shërbimit të parapara nën këtë Rregull;
  - (d) Vënien e çfarëdo gjobe për cilësdo shkelje të Kushteve të Licencës së Shërbimit ose për shkeljen e cilësdo dispozitë të këtij Rregulli.
- 57.2 Ofruesi i Shërbimeve për Ujë dhe Ujërave të Zeza gjithashtu mund të ankohet në gjyqet e Kosovës për çfarëdo vendimi të Komisionit Shqyrtues të ndërmarrë për cilatdo vendime konkrete për sa i përket zbatimit të këtij Rregulli në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Ujërave të Zeza të referuar në nën-nenin 57.1.

57.3 Me lëshimin e cilitdo vendim konkret për zbatimin e kësaj Rregulle, Rregullatori do ta informojë Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të cilit i adresohet vendimi, për të drejtën e tij për ankesë në pajtim me këtë Nen.

## **PJESA XI: TË NDRYSHME**

### **Neni 58: Gjuhët Zyrtare të Rregullës**

- 58.1. Kjo Rregull nxjerret dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:
- (a) Angleze;
  - (b) Shqip; dhe
  - (c) Serbe.
- 58.2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të verzioneve në të cilat kjo rregull është nxjerrë, verzioni në gjuhën Angleze do të mirret si bazë.

### **Neni 59: Hyrja në Fuqi**

- 59.1 Kjo Rregull do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit.
- 59.2 Ofruesit e Shërbimeve për Ujë dhe Ujëra të Zeza do të kenë tridhjetë (30) ditë të punës të bien në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulle që llogariten nga data e hyrjes në fuqi të përcaktuar me nën-nenin 59.1.

---

**Paulino Brillhante Santos**  
**Drejtor**

---

**Afrim Lajci**  
**Zëvendës Drejtor**

**Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina**

**SHTOJCAT**

## SHTOJCA 1

FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE PËR SHËRBIMET E FURNIZIMIT TË UJIT ME SHUMICË NË KOSOVË

**ME KËTË BËHET APLIKIMI TE ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA PË LICENCË TË SHËRBIMIT PËR OFRIMIN SHËRBIMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE TË UJËRAVE TË ZEZA. NA ËSHTË E QARTË QË DHËNIA E INFORMATAVE FALSE MUND TË REZULTOJË ME REFUZIMIN E LICENCËS SË SHËRBIMIT**

KY APLIKACION DUHET TË DËGOHET TE:	VETËM PËR PËRDORIM ZYRTAR						
<b>ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA</b>  RRUGA: BAJRAM KELMENDI P.N. PRISHTINË, KOSOVË	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 70%; border-right: 1px dashed black;"> <b>Data e Marrjes</b>  <b>Data e Pranimit</b>  <b>Data e Refuzimit</b> </td> <td style="width: 30%;"></td> </tr> <tr> <td colspan="2"> <b>Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit është paguar:</b> </td> </tr> <tr> <td colspan="2" style="text-align: right;"> <input type="checkbox"/> Po  <input type="checkbox"/> Jo                 </td> </tr> </table>	<b>Data e Marrjes</b> <b>Data e Pranimit</b> <b>Data e Refuzimit</b>		<b>Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit është paguar:</b>		<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	
<b>Data e Marrjes</b> <b>Data e Pranimit</b> <b>Data e Refuzimit</b>							
<b>Taksa e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit është paguar:</b>							
<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo							

PJESA 1 – INFORMATAT E PËRGJITHSHME IDENTIFIKUESE PËR LICENCË TË SHËRBIMIT			
(a) Emri			
(b) Adresa			
(c) Numri kryesor i telefonit	(d) Numri i Telefonit Mobil		
(e) Numri i Telefaksit	(f) E-Mail Adresa		

PJESA 2 – PERSONI KONTAKTUES I APLIKUESIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT			
(a) Emri i personit kontakt.			
(b) Titulli dhe pozita			
(c) Numri i telefonit të zyrës	(d) Numri i telefonit mobil		

PJESA 3 – STAFI MENAXHERIAL	
(a) Emri i Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës	
(b) Emri i Drejtorit Menaxhues (ose Drejtorit Gjeneral)	
(c) Emri i Udhëheqësit Financiar	
(d) Emri i Udhëheqësit të Operativës	

PJESA 4 – SHËRBIMET QË OFROHEN	
(a) Furnizimi me Ujë: Trajtimi, distribuimi	<input type="checkbox"/> Po <span style="margin-left: 100px;"><input type="checkbox"/> Jo</span>
(b) Ujërat e Zeza (Kanalizimi): Grumbullimi, trajtimi, derdhja	<input type="checkbox"/> Po <span style="margin-left: 100px;"><input type="checkbox"/> Jo</span>
© Furnizimi i Ujit me Shumicë	<input type="checkbox"/> Po <span style="margin-left: 100px;"><input type="checkbox"/> Jo</span>

**PJESA 5 – ZONA E SHËRBIMIT**

<b>(a) Emrat e Komunave që shërbehen</b> <i>Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet të radhisë të gjitha komunat duke përfshi edhe ato që shërbehen nga Ofruesi i Shërbimeve që është nën autoritetin e tij administrativ.</i>	1-	5-
	2-	6-
	3-	7-
	4-	8-
<b>(b) Emrat e fshatrave dhe vendbanimeve që u ofrohen shërbimet në ditën e Aplikimit për Licencë të Shërbimit</b> <i>Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet të radhisë të gjitha fshatrat dhe vendbanimet duke përfshi edhe ato që shërbehen nga Ofruesi i Shërbimeve që është nën autoritetin e tij administrative. (Shtoni fleta shtesë sipas nevojës)</i>	1-	13-
	2-	14-
	3-	15-
	4-	16-
	5-	17-
	6-	18-
	7-	19-
	8-	20-
	9-	21-
	10-	22-
	11-	23-
	12-	24-

**PJESA 6 – KONSUMATORËT QË U OFROHEN SHËRBIMET**

<b>(a) Numri total i banorëve që shërbehen në datën e Aplikacionit për Licencë të Shërbimit</b> <i>Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet të përfshijë në numrin total të banorëve një vlerësim të atyre që u ofrohen shërbimet nga Ofruesit e Shërbimeve që janë nën Autoritetin e tij Menaxhues.</i>		
<b>(b) Numri i amvisërive që shërbehen</b> <i>Aplikuesi për Licencë të Shërbimit duhet të përfshijë në total numrin e Konsumatorëve Shtëpiak që shërbehen nga Ofruesit e Shërbimeve që janë nën Autoritetin Menaxherial të tij.</i>	<b>Tani:</b>	<b>Pritet pas 12 muajve:</b>
<b>(c) Numri i Konsumatorëve Komercial/Industrial</b>	<b>Tani:</b>	<b>Pritet pas 12 muajve:</b>
<b>(d) Numri i Konsumatorëve Institucional</b>	<b>Tani:</b>	<b>Pritet pas 12 muajve:</b>
<b>(e) Emrat e fshatrave dhe vendbanimeve tjera që pritet se do të u ofrohen shërbimet në 12 muajt e ardhshëm pas aplikimit për Licencë të Shërbimit</b>	1-	5-
	2-	6-
	3-	7-
	4-	8-

**PJESA 7 – BURIMET E UJIT**

<b>(a) Emri(at)</b>	1.	2.	3.
<b>(b) Lokationi(et)</b>			
<b>(c) Kategoria (nëntokësorë, sipërfaqësor)</b>			
<b>(d) Lloji (pus, burim, liqe, lum)</b>			
<b>(e) Sasia mesatare e kaptimit (m3/ditë)</b>			
<b>(f) Vëllimi vjetor i kaptimit (m3/vit)</b>			

**PJESA 8 – STABILIMENTET E TRAJTIMIT TË UJIT**

(a) Emri(at)			
(b) Lokationi(et)			
(c) Lloji: (koagulim, filtrim, desinfektim)			
(d) Kapaciteti Maksimal Ditor (m3/ditë):			
(e) Kemikaliet që shfrytëzohen:			

**PJESA 9 – OBJEJTET PËR DEPONIMIN (REZERVIMIN) E UJIT TË TRAJTUAR**

(a) Emri(at)			
(b) Lokationi(et)			
(c) Kapaciteti (m3)			
(d) Lloji (nëntokësor, I ngritur)			
(e) Materiali (beton, çelik, tjetër)			

**PJESA 10 – SHKALLA E MBULIMIT ME SHËRBIMET E FURNIZIMIT ME UJË**

(a) Numri i kyqjeve sipas kategorive të konsumatorëve	Amvisëri	Komercial & Industrial	Institucional	Total
(b) Numri total i banorëve në Zonën e Shërbimit		(c) Popullata e mbuluar (%)		(d) Orë / ditë

**PJESA 11 – SHKALLA E MBULIMIT ME SHËRBIMET E UJËRAVE TË ZEZA**

(a) Numri i kyqjeve sipas kategorive të konsumatorëve	Amvisëri	Komercial & Industrial	Institucional	Total
(b) Numri total i banorëve në Zonën e Shërbimit		(c) Popullata e mbuluar (%)		

**PJESA 12 - PERSONELI**

(a) Numri total i të punësuarve me orar të plotë		(b) Numri i të Punësuarve në Furnizim me Ujë (O & M)	
(c) Numri total i punëtorëve në Kanalizim (O&M)		(d) Numri i të punësuarve në Administratë	

**PJESA 13 – AUTORIZIMI DHE NËNSHKRIMI PËR APLIKACION PËR LICENCË TË SHËRBIMIT**

I nënshkruari më poshtë vërteton se ai është i autorizuar nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit të nënshkruajë dhe ta dorëzojë Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për (të nënvizohet ajo që është e aplikueshme):

- (a) Shërbimet e Furnizimit me Ujë
- (b) Shërbimet e Grumbullimit dhe Derdhjes së Ujërave të Zeza
- (c) Shërbimet e Furnizimit të Ujit me Shumicë

Dhe se deklaratat dhe informatat në Aplikacion janë të vërteta, të sakta dhe korrekte.

(Shtypeni emrin dhe titullin e personit që nënshkruan në emër të Aplikuesit për Licencë Shërbimit)

Emri: \_\_\_\_\_

Titulli: \_\_\_\_\_

Emri i Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

## SHTOJCA 2

### AUTORIZIMI I BORDIT MBIKQYRËS

---

*Letra, të cilës i referohet Rregulli për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë, duhet të dorëzohet sipas formatit dhe përmbajtjes në vijim,, nga Bordi Mbikqyrës i Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duke bërë Aplikacionin për Licencë të Shërbimit në logon e vet zyrtare dhe të nënshkruar nga Kryesuesi i Bordit Mbikqyrës dhe të dorëzohet nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit te Rregullatori.*

Datë: Dita-Muaji-Viti

*[Insertoni emrin e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza]*

*[Insertoni adresën e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza]*

Për: *[Insertoni emrin e Drejtorit Menaxhues të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza]*  
Managing Director

Lënda: Autorizimi i Bordit Mbikqyrës për Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë

Ne Bordi Mbikqyrës i <*insertoni emrin komplet të Ofruesit të Shërbimeve*> jemi të ndërgjegjshëm për nevojë e ndërmarrjes për të aplikuar për marrjen e Licencës së Shërbimit nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina.

Për më tepër, ne konfirmojmë se Drejtori Menaxhues i <*insertoni emrin komplet të Ofruesit të Shërbimeve*>ka mandat dhe autorizim të plotë në emër të Ofruesit të përmendur të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për të aplikuar për Licencë të Shërbimit dhe për të ofruar dokumentet e nevojshme sipas Rregullit për Licencim të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë, për këtë qëllim.

Me respekt,

*[Shtypeni emrin e personit që e nënshkruan letrën]*  
*[Shtypeni titullin e personit që e nënshkruan letrën]*

*[Nënshkrimi i personit emri i të cilit është shtypur]*

### SHTOJCA 3

#### APROVIMI I DEKLARATËS FINANCIARE

*Letra, të cilës i referohet Rregulli për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë, duhet të dorëzohet sipas formatit dhe përmbajtjes në vijim, në etrën me logon zyrtare të Agjencisë kosovare të Mirëbesimit dhe e nënshkruar nga personi që ka mandat për këtë dhe të dorëzohet nga Aplikuesi për Licencë të Shërbimit me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit te Rregullatori.*

*[Insertoni emrin e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza]*

*[Insertoni adresën e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza]*

Për: *[Insertoni emrin e Drejtorit Menaxhues të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza]*  
Managing Director

Lënda: Deklaratë Financiare  
*[Insertoni emrin komplet të Ofruesit të Shërbimeve]*

Bashkangjitur e keni daklaratën finaciare të fundit që është në dispozicion *[të indikohet se a është “e revizionuar” ose “jo e revizionuar”]* për ndërmarrjen tuaj e cila përfshinë periudhën 12 mujore duke filluar *[të shënohet data e fillimit si Dita-Muaji-Viti]* dhe deri më *[të shënohet data e përfundimit si Dita-Muaji-Viti]*.

Ne dëshmojmë se kontot dhe vlerat që përmban deklarate financiare e bashkangjitur përfshijnë të gjitha operimet financiare të ndërmarrjes suaj, që janë aprovuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, paraqesin gjendje e vërtetë dhe korrekte financiare të ndërmarrjes.

Me respekt,

*[Shtypeni emrin e personit që e nënshkruan letrën]*  
*[Shtypeni titullin e personit që e nënshkruan letrën]*

*[Nënshkrimi i personit emri i të cilit është shtypur]*

Bashkangjitjet:

## SHTOJCA 4

### FORMAT I CURRICULUM VITAE BASHKANGJITUR ME APLIKACION PËR LICENCË

---

**Titulli i Postit:** *[Insertoni titullin e postit të fundit që kryeni]*

**Kualifikimet:**

- **Arsimimi:**  
*Rradhitini emrat e shkollave, kolegjeve, universiteteve, trajnimeve profesionale që i keni ndjekur, duke përfshi edhe vitin e ndjekjes dhe certifikatat dhe titujt që i keni marrë.*
- **Eksperiencia:**  
*Jepni një përshkrim të shkurtër të përvojës në punë, duke filluar nga përvoja e fundit. Për secilën, jepni emrin e punëdhënësit, adresën dhe numrin e telefonit, vitin e fillimit dhe të mbarimit për secilin punëdhënës, dhe titullin e pozitës.*

**Njohuritë,  
Shkathësitë, aftësitë:**

- **Patent-shoferi**  
*Shënojeni nëse keni patent-shofer valid në Kosovë (po / jo). Nëse “po” jepeni datën e lëshimit dhe emrin e autoritetit që e ka lëshuar. Kopja e patent-shoferit duhet ti bashkangjitet CV-së.*
- **Aftësitë kompjuterike**  
*Renditini nivelin e juaj të aftësive kompjuterike si “nuk kam njohuri”, “kam njohuri” dhe “kam njohuri të madhe”. Poashtu renditini emrat e aplikacioneve softuerike që i njihni në mënyrë funksionale.*
- **Gjuhët**  
*Renditini aftësitë gjuhësore. Për secilën gjuhë shënoni aftësinë në të lexuar, shkruar, dhe të folur në formë të “fillestar”, “mire”, “shkelqyeshëm” dhe “nivel i gjuhës amtare”*

**Tjera:**

- **Karakteristikat Personale:**  
*Renditini karakteristikat speciale që do të kishin ndikim në pozitën për të cilën po aplikoni.*
- **Shëndeti:**  
*Identifikoni gjendjen e juaj të përgjithshme shëndetësore në formë të ndikimit që mund të ketë në pozitën për të cilën po aplikoni. Shënoni çfarëdo kufizimi të punës që mund të keni për shkaqe shëndetësore*
- **Shënimet kriminale:**  
*Shënoni nëse keni qenë ndonjëherë i dënuar për ndonjë krim dhe nëse “po”, shënoni natyrën e dënimit dhe vitin e dënimit.*

## SHTOJCA 5

### LISTA KONTROLLUESE E KOMPLETIMIT ADMINISTRATIV PËR APLIKACION PER LICENCE TE SHERBIMIT

TË GJITHË ARTIKUJT NË KËTË LISTË KONTROLLUESE I REFEROHEN PJESËVE DHE ARTIKUJVE NGA APLIKACIONI PË LICENCË TË SHËRBIMIT. APLIKUESI MUND TA PËRDORI KËTË LIST SI UDHËZUES QË TË SIGUROHET PËR KOMPLETIMITIN E APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT. NUK ËSHTË OBLIGATIVE QË KY FORMULAR TË DËRGOHET ME APLIKACION, MEGJITHATE ËSHTË E KËSHILLUESHME PËR APLIKUESIN QË TA BËJË KËTËO.

1. IDENTIFIKIMI I APLIKUESIT			
<b>(a) Emri</b>			
<b>(b) Adresa</b>			
<b>(c) Numri kryesor i telefonit</b>		<b>(d) Numri i Telefonit Mobil</b>	
<b>(e) Numri i Telefaksit</b>		<b>(f) E-Mail Adresa</b>	
2. FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË ( <i>"Pjesët" sikurse në formularin e Aplikacionit për Licenë</i> )			
PJESA 1 – Identifikimi i Aplikuesit	Shëno me “√” vetëm njërën		Vërejtje
(a) Emri	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Adresa	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Numri kryesor i telefonit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(e) Numri i Telefaksit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(f) Adresa e e-mailit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
PJESA 2 – Personi Kontaktues i Aplikuesit	Shëno me “√” vetëm njërën		Vërejtje
(a) Emri i personit kontakt.	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Titulli dhe pozita	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Numri i telefonit të zyrës	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Telefoni mobil	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
PJESA 3 – Menaxherët	Shëno me “√” vetëm njërën		Vërejtje
(a) Emri i Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Emri i Drejtorit Menaxhues (ose Drejtori Gjeneral)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Emri i Udhëheqësit Financiar	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Emri i Udhëheqësit të Operativës	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
PJESA 4 – Shërbimet e Ofruara	Shëno me “√” vetëm njërën		Vërejtje
(a) Furnizimi me Ujë: Trajtimi, distribuimi	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Ujërat e Zeza (Kanalizimi): Grumbullimi, trajtimi, derdhja	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Furnizimi i Ujit me Shumicë	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
PJESA 5 – Zona e Shërbimit	Shëno me “√” vetëm njërën		Vërejtje
(a) Emrat e Komunave që shërbehen	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Emrate Fshatrave dhe Vendbanimeve që shërbehen	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
PJESA 6 – Popullata e Shërbyer	Shëno me “√” vetëm njërën		Vërejtje
(a) Numri total I banorëve që u ofrohen shërbimet	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Numri i Konsumatorëve Shtëpiak që u ofrohen Shërbimet	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	

(c) Numri i Konsumatorëve Komerical. & Industr. që shërbehen	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(e) Numri i Institucioneve Publike që shërbehen	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(j) Numri i Fshatrave që do të shërbehen në të ardhme	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 7 – Burimi i Ujit</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Emri(at)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Lokationi(et)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Kategoria (nëntokësorë, sipërfaqësor)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Lloji (pus, burim, liqe, lum)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(e) Sasia mesatare e kaptimit (m3/ditë)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(f) Vëllimi vjetor i kaptimit (m3/vit)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 8 – Stabilimentet e Trajtimit të Ujit</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Emri(at)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Lokationi(et)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Lloji: (koagulim, filtrim, desinfektim)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Kapaciteti Maksimal Ditor (m3/ditë):	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(e) Kemikaliet që shfrytëzohen:	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 9 – Objektet për Deponimin e Ujit të Trajtuar</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Emri(at)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Lokationi(et)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Kapaciteti (m3)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Lloji (nëntokësor, i ngritur)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(e) Materiali (beton, çelik, tjetër)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 10 – Shkalla e Mbulimit me Shërbime të Ujit</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Numri i kyqjeve sipas kategorive të konsumatorëve	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Numri total i banorëve në Zonën e Shërbimit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Popullata e mbuluar me shërbime (%)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Kohëzgjatja e Shërbimit në orë/ditë	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 11 – Shkalla e Mbulimit me Shërbime të Iliërave të Zeza</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Numri i kyqjeve sipas kategorive të konsumatorëve	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Numri total i banorëve në Zonën e Shërbimit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Popullata e mbuluar me shërbime (%)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 12 - Personeli</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Numri total i të punësuarve me orar të plotë	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Numri i punëtorëve në Furnizim me Ujë (Oper. & Mirëmb.)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Numri i punëtorëve në Ujëra të Zeza (Oper. & Mirëmb.)	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
<b>PJESA 13 – Autorizimi dhe Nënshkrimi</b>	Shëno me “√” vetëm njërën		<b>Vërejtje</b>
(a) Autorizimi, Nënshkrimi dhe data	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	

**3. DOKUMENTET E NEVOJSHME** (Të gjitha dokumentet e kërkuara duke përfshirë edhe formularin e kompletuar të Aplikacionit për Licencë të Shërbimit, duhet të dorëzohen në tri kopje)

Dokumentet e nevojshme	Shënoni me “√” vetëm njërin		Vërejtje
(a) Letra e Aplikacionit nga Bordi Mbikqyrës për ZRUM	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(b) Kopja e statutit ose e “dokumentit të themelimit”	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(c) Harta e Zonës së Shërbimit me perimetrin e definuar	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(d) Struktura organizative - organogrami	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(e) Emrat dhe curriculum vitae të Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës, Drejtorit Menaxhues, Menaxherit Financiar, të Menaxherit të Operativës dhe të menaxherëve tjerë	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(f) Smarrëveshja për Shërbim me komunat që u ofrohen shërbimet	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(g) Autorizimi nga MMPH ose aplikacioni për autorizim për marrjen e ujit për trajtim dhe për shkarkimin e ujërave të zeza	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(h) Tarifat e tanishme të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe data kur janë caktuar	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(i) Kopja në fuqi e certifikates së regjistrimit të biznesit e lëshuar për Aplikuesin e për Licencë të Shërbimit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(j) Kopja e Certifikatës së Regjistrimit për tatimin në Vlerën e Shtuar (TVSH) e lëshuar për Aplikuesin për Licencë të Shërbimit dhe dëshmia se TVSH është paguar	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(k) Konfirmimi me shkrim nga Menaxheri Financiar i Aplikuesit për Licencë se të gjitha pagat dhe kontributet e punëtorëve janë paguar dhe janë konform kontratës me punëtorët respektiv	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(l) Kopja e deklaratës së fundit financiare e vërtetuar nga AKM	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(m) Kopja e deklaratave bankare për llogaritë bankare që i mban Aplikuesi për Licencë për periudhën që mbulon 6 muaj para dates së Aplikacionit	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(n) Fatura e Tatimit në Pronë e vulosur “paguar në tërësi” nga zyrtari i autorizuar i komunës në kuadër të së cilës është i vendosur Aplikuesi	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	
(o) Faturat e energjisë elektrike, ngrohjes, telefonisë dhe mbeturinave të vulosura “paguar në tërësi”	<input type="checkbox"/> Prezente	<input type="checkbox"/> Mungon	

## SHTOJCA 6

### CERTIFIKATA E LICENCIMIT E ZRUM PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË

NUMRI I LICENCËS SË SHËRBIMIT: [CLICK here AND INSERT LICENSE NUMBER]

EMRI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE : [CLICK HERE AND INSERT LICENSEE NAME]

DATA E LËSHIMIT: [CLICK HERE AND INSERT DATE] DATA E SKADIMI:

DATA E MODIFIKIMIT: [IF APPLICABLE, CLICK HERE AND INSERT DATE, IF NOT TYPE NOT APPLICABLE]

EMRI I DREJTORIT TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE: [CLICK HERE AND INSERT DIRECTOR NAME]

ADRESA E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE: [CLICK HERE AND INSERT ADDRESS]

ZONA E SHËRBIMIT: [CLICK HERE AND INSERT MUNICIPALITY AND SERVICE AREA NAME]

EMRAT E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE QË JANË NËN AUTORITETIN MENAXHUES TË TË LICENCUARIT ME KËTË LICENCË SHËRBIMIE:

1. [CLICK HERE AND INSERT SERVICE PROVIDER NAME]
2. [CLICK HERE AND INSERT SERVICE PROVIDER NAME]
3. [CLICK HERE AND INSERT SERVICE PROVIDER NAME]
4. [CLICK HERE AND INSERT SERVICE PROVIDER NAME]

**AKTIVITETE E AUTORIZUARA ME KËTË LICENCË TË SHËRBIMIT:**

Konform Rregullores No. 2004/49 Për Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë, Licenca e Shërbimit lëshohet për [CLICK HERE AND INSERT LICENSEE NAME] për qëllimin specifik të ofrimit në Zonën e Shërbimit:

[CLICK here AND INSERT name of municipality where the service will be provided] të Shërbimeve vijuese:

- Trajtimi i Ujit
- Distribuimi i Ujit
- Grumbullimi i Ujërave të Zeza
- Trajtimi i ujërave të Zeza
- Furnizimi me Ujë me Shumicë

#### KUFIZIMET

Asnjë

#### DISPOZITAT DHE KUSHTET TJERA TË APLIKUESHME:

Kjo dhënie e Licencës së Shërbimit është e bazuar në informatat e dhëna nga Ofruesi I Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në kohën e dorëzimit të Aplikacionit më [CLICK HERE AND INSERT LICENSE APPLICATION DATE]. Licenca e Shërbimit mund të revokohet nëse informatat e dhëna nga Ofruesi I Shërbimeve konstatohet se janë jokorrekte dhe/ose përfaqësojnë gabimish dhe nëse konstatohet se konditat dhe dispozitat nën të cilat është lëshuar Licenca e Shërbimit nuk janë përmbushur. Licenca e Shërbimit është efektive në ditën e lëshuarjes dhe do të jetë në fuqi deri në Datën e Skadimit të dhënë më lartë përveq nëse revokohet konform dispozitave të Rregullit për Licencim të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë të Zyrës Regullatore për Ujë dhe Mbeturina

NËNSHKRUAR:

[CLICK HERE AND INSERT DATE]

DATË:

NAME: [CLICK HERE AND INSERT NAME]

TITULLI: Drejtori i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

VULA ZYRTARE E ZYRËS  
RREGULLATORE PËR UJË  
DHE MBETURINA

## SHTOJCA 7

### PËRMBAJTJA E LICENCËS SË SHËRBIMIT TË ZRUM

Tabela e Përmbajtjes së Licencës që ZRUM lëshon për Ofruesit e Shërbimeve

Seksioni	Titulli dhe Përmbajtja
<b>1</b>	<b>Definicionet dhe Interpretimet</b>
1.A.	Definicionet
1.B.	Interpretimet
	Nëse një pjesë e zbrazët, atëherë ajo pjesë eliminohet
	Nëse një organizatë ndërpritet të ekzistojë, atëherë seksionet përkatëse kanë të bëjnë me organizatën pasardhëse
	Nëse ka jokonsistencë ndërmjet Licencës së Shërbimit dhe Kontratës me Konsumatorë, mbizotëron Licenca
<b>2</b>	<b>Synimi i Licencës</b>
	Ti mundësojë dhe të kërkojë nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose Furnizuesit të Ujit me Shumicë që në mënyrë të lighjshme të ofrojë shërbimet e specifikuar Brenda zones së caktuar të shërbimit
2.A.	Kohëzgjatja e Licencës
2.B.	Përtrirja
2.C.	Ndryshimi i Licencës
2.D.	Ndërprerja e Licencës
<b>3</b>	<b>Përgjegjësitë e Ofruesit të Shërbimeve</b>
	Ti përmbahet licencës dhe të gjitha ligjeve të aplikueshme
	Ofrorë furnizim të besueshëm dhe të mjaftueshëm me ujë të sigurtë të pijes për popullatën në zonën e vet të shërbimit
	Ofrorë në mënyrë adekuate shërbimet e grumbullimit dhe të largimit të ujërave të zeza për popullatën në zon/n e vet të shërbimit
	Të mbrojë mjedisin duke kryer operimet e veta në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi për mjedisin
	Të operojë si biznes i qëndrueshëm
	Nëse është caktuar nga AKM si Ofrues Kryesor i Shërbimeve, atëherë të lidhë Marrëveshje për Menaxhim dhe Operim me Ofruesit Lokal të Shërbimeve në regjionin e vet
<b>4</b>	<b>Autorizimi me Licencë dhe Zona e Shërbimit</b>
	Licenca jepet për ti mundësuar dhe për të kërkuar prej Ofruesit të Shërbimeve që të ndërtojnë, operojnë, menaxhojnë dhe ti mbajnë efikas, të koordinuar dhe financiarisht të qëndrueshëm sistemet për ofrimin e shërbimeve të dhëna
<b>5</b>	<b>Shërbimet (Nënvizoni të gjitha ato që aplikohen)</b>
	Furnizimi i Ujit me Shumicë
	Trajtimi i Ujit (dezinfektimi, filtrimi, para-trajtimi)

Seksioni	Titulli dhe Përmbajtja
	Distribuími i Ujit
	Largimi i Ujërave të zeza me system gypor
	Derdhja e Ujërave të zeza
<b>6</b>	<b>Zona e Operimit</b>
	Renditni zonat dhe shënoni nëse janë zona "me presion të ulët" ose "me ndërprereje të shërbimit " (i.e. jo kontinuele)
<b>7</b>	<b>Kyqjet</b>
	Aplikacioni për kyqje për çfarëdo prone që gjindet në zonën e shërbimit duhet të aprovet me kusht të sigurimit të furnizimit të shërbimit të sigurtë, të qëndrueshëm dhe financiarisht të arësytueshëm
<b>8</b>	<b>TëDrejtat e Konsumatorëve</b>
	Konsumatori = ka hyrë në Kontratë të Shërbimit
	Kontrata e Shërbimit të Konsumatorëve
	Procedurat për Ankesat e Konsumatorëve, Borxhet, dhe Shkyqjet
	Marrja e komenteve të konsumatorëve
<b>9</b>	<b>Niveli Minimal i Shërbimit</b>
<b>10</b>	<b>Taksat në Lidhje me Licencën e Shërbimit</b>
<b>11</b>	<b>Tarifat</b>
<b>12</b>	<b>Zgjidhja e Kontesteve</b>
	Ankesat e Konsumatorëve
	Ankesat nga Agjencitë tjera dhe Organizatat
	Mbajtja e Shënimeve dhe Raportimi
<b>13</b>	<b>Transferi, Ndryshimi, Revokimi, Mbarimi</b>
	<b>Bashkangjitjet</b>
<b>#1</b>	Zona e Shërbimit
<b>#2</b>	Niveli Minimal I Shërbimit
<b>#2A</b>	Për Zonat Urbane
<b>#2B</b>	FPër Zonat Rurale
<b>#3</b>	Lista e Raporteve që duhet ti dërgohen Rregullatorit